



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA E ARSIMIT**

Nr. _____ prot.

Berat , më _____.____.2024

NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri: Qendra Ekonomike e Arsimit , Bashkia Berat
Adresa: Rruga Antipatrea
Tel/Faks: 0698890930
E-mail: info@bashkiabertat.gov.al
Adresa e ueb-faqes: www.bashkiaberat.gov.al,

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri B.Kokoshi
E-mail bkokoshi14@epoka.edu.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar, me mjete elektronike

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: Mallra

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-26884-10-29-2024

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: F.V Lende djegese pelet

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 09110000-3 (lende djegese te ngurta)

8. Fondi limit: 4 205 000 (kater milion e dyqinde e pese mije) leke pa tvsh

9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit: mbeshtetur në ligjin nr.162, datë 23.12.2020, i ndryshuar“Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar:

Afati i fundit për pranimin e ofertave 20.11.2024

Shënim:

Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.

Në shtojcën 6 të DST-ve janë përcaktuar Specifikimet teknike si më poshtë :

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura e posaçme, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

●•Certifikimi ENplus A1

●•Nxehtesia > 4.6 KWh/kg

- Diametri : 6mm
- Gjatesia : 3.15 - 40 mm
- Permbajtja e lageshtise < 10.0%
- Perqindja e pluhurit : < 0.5%
- Pesha specifike > 600kg/m³
- Temperatura e shkrirjes se hirit : 1200 grade
- Paketimi: 15 kg
- Rezistenca mekanike > 98%
- Lloji I drurit : Dru Halore

Prodhim konform standarteve CE

Ky kriter ndryshon si me poshte:

- *Specifikimet teknike janë hartuar nga strukture e posaçme, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*
- Fuqia kalorifike 4 > 4.6 KWh/kg
- Diametri: 6mm
- Gjatesia: 20 - 40 mm
- Permbajtja e lageshtise me e vogel se 10 %
- Perqindja e pluhurit: me e vogel 0.7 %
- Paketimi:15 kg.
- Rezistenca mekanike > 98%
- Lloji i drurit: Dru Ah

Ne piken 2.3.4 te DST-ve: Ne rast se operatori ekonomik ofertues nuk eshte prodhues, ai duhet te paraqese kontratë furnizimi noteriale/autorizim nga prodhuesi ose distributor zyrtar per mallin objekt prokurimi shoqeruar me katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve, ku te dallohen qarte specifikimet teknike te mallit. Ne rastin e kontrates se furnizimit/autorizimit me distributorin te dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin. Kontrata/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme nga Autoriteti Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Ky kriter ndryshon si me poshte:

Ne rast se operatori ekonomik ofertues nuk eshte prodhues, ai duhet te paraqese kontratë furnizimi noteriale/autorizim nga prodhuesi ose distributor zyrtar per mallin objekt prokurimi shoqeruar me skeda teknike të prodhuesit/ve, ku te dallohen qarte specifikimet teknike te mallit. Ne rastin e kontrates se furnizimit/autorizimit me distributorin te dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin. Kontrata/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme nga Autoriteti Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Ne pike **2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raportet e testimi nga laboratorë të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë për produktin objekt prokurimi me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara. Dëshmia me rezultatet e testeve zyrtare duhet të jetë lëshuar brenda vitit 2024.

Ky kriter ndryshon si me poshte:

Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese flete analizen te leshuara nga laboratore kombetare ose nderkombetare te akredituar, per produktin objekt prokurimi me qellim vertetimin e permbushjes se specifikimeve teknike dhe standarteve te kerkuara. Deshmia me rezultatet e testimeve zyrtare duhet te jete leshuar brenda vitit 2024.

Ne piken **2.3.7** Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik. Kerkohet te jene ne dispozicion keto mjete pune.

Shenim: (Ne rastin kur punonjesit shofer jane te kontraktuar me kontrate pune (*respektivisht per mjetin e marrë me qera*) nuk kerkohet te figurojne ne listpagesen e shoqerise)

Ky kriter ndryshon si me poshte:

Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik. Kerkohet te jene ne dispozicion keto mjete pune.

Shenim: (Ne rastin kur O.E ne permbushje te kriterit 2.3.7, deshmon se Mjet transporti, kamion cope 1, eshte me kontrate qiraje shoqeruar me: dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), Certifikaten e per transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme), duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qirase/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, si dhe per punonjesin shofer duhet te dorezohej kontrata e punes e nenshkruar midis paleve, nga momenti i shpalljes fitues, me afat sipas kohezgjatjes se kontrates dhe nuk kerkohet qe te figurojne ne listpagesen e shoqerise) .

Njesia e Prokurimit

TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KLODIANA HOXHA